



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

### V E N D I M

Nr. 25, datë 26.10.2009

### PËR “PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “ENERGJIA DIELLORE – ALTERNATIVË PROMJEDISORE DHE EKONOMIKE””

Mbështetur në nenin 10, pika 3/II, shkronja “c”, nenin 19, pika 9, nenin 32, shkronja “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenin 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; nenin 6, shkronja “b” të ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar) dhe VKB-në nr.1, datë 03.02.2009 për “Miratimin në parim të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2009-2011 dhe miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2009”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak i Tiranës,

### V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për projektin *“Energjia diellore – alternativë promjedisore dhe ekonomike”*, në një shumë prej 1,573,560 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tremijë e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh.  
(sipas tabelës 1 bashkëlidhur projekt-vendimit)
2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi do të shtojnë buxhetin e Drejtorisë nr.3 të Punëtorëve të Qytetit për investime në Programin e Shërbimeve Sociale për vitin 2009, duke pakësuar fondin rezervë të Bashkisë së Tiranës miratuar me buxhetin e vitit 2009.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria nr.3 e Punëtorëve të Qytetit dhe Drejtoria e Menaxhimit të Shërbimeve të Infrastrukturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

**K R Y E T A R**